



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
DIVIZIONI JURIDIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

27.09.2021

Drejtuar: “Lizard Shpk”, me Nipt: L01508026P,

Adresa: Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Tuneli 2, Dyqani 4,. Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar \_Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit/lot: REF-04233-08-31-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shtypshkrime për komunikimin, promovimin dhe pritjet zyrtare”**, me kohëzgjatje 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 132 datë 7 Shtator 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Univers Promotions Shpk”, me Nipt: K81324039M, me adresë Kashar, Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, Tiranë, me ofertë ekonomike 1.688.000 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa tvsh.
2. Operatori Ekonomik Lizard Shpk”, me Nipt: L01508026P, me adresë Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Tuneli 2, Dyqani 4, Tiranë me ofertë ekonomike 1.973.000 Lekë pa TVSH, (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) Lekë pa TVSH
3. Operatori ekonomik ADEL CO, me Nipt L22117021M nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion, ne lidhje me proceduren e prokurimit në fjale.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Univers Promotions Shpk”, me Nipt: K81324039M, me adresë Kashar, Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, Tiranë, me ofertë ekonomike 1.688.000 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

Për arsyet e mëposhtëme:

Duke iu referuar dokumentacionit dhe ofertës së paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar mangësi ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Univers Promotions” Shpk

Referuar përcaktimeve të nenit 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe të nenit 82, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO konkludon se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**Univers Promotions Shpk**”, është ulur me shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur për këtë procedurë, pra është anomalisht e ulët. Për këtë KVO-ja i kërkoi operatorit ekonomik sqarime mbi elementet e ofertës me anë te SPE. OE nuk paraqiti asnje dokumentacion sqarues brenda afatit të caktuar, 3 ditë pune, për të shpjeguar në lidhje me çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Për këtë arsye KVO vendosi skualifikimin e OE “**Univers Promotions Shpk**”.

2. Operatori ekonomik ADEL CO, me Nipt L22117021M nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Për arsyet e mëposhtëme:

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion, ne lidhje me proceduren e prokurimit në fjale.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga “Lizard Shpk”, me Nipt: L01508026P, me adresë Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Tuneli 2, Dyqani 4, Tirane, me vlerë totale prej 1.973.000 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Pirro Vengu**